



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

STRATEGJIA E MBROJTJES SOCIALE 2019 – 2022

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Postuar më: 10.07.2019

Njoftim për Konsultimin Publik

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2019-2022

“Në vijim të Rishikimit Afatmesëm të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS) dhe planit të veprimit, si një strategji e rëndësishme dhe e vlefshme për reformat e ndërmarra nga qeverisja qendrore në bashkëpunim me atë vendore, periudha e SKMS u zgjat deri në vitin 2022. Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka rishikuar dhe përditësuar dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të mbrojtjes sociale deri në periudhën e përditësuar. Objektivi kryesor është të avancojë procesin e reformave të nisura tashmë të Ndihmës Ekonomike, të Vlereësimit Bio-Psikosocial dhe Pagesave të Affësisë së Kufizuar, dhe të Shërbimeve Sociale, si dhe të forcojë bashkëpunimin e qeverisjes qendrore dhe atë vendore, si dhe të grupeve të interesit, duke përgatitur një dokument strategjik dhe plan veprimi të mbrojtjes sociale të rishikuar dhe të përditësuar.

Procesi i përditësimit të dokumentit strategjik dhe planit të veprimit të mbrojtjes sociale nisi në fillim të marsit 2019, nën kujdesin dhe udhëheqjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i mbështetur me asistencë teknike nga UNICEF. Procesi i përditësimit është një vijim i natyrshëm i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, i cili bazohet dhe në një vlerësim afatmesëm të strategjisë, që përcaktoi disa gjetje dhe rekomandime.

Bazuar mbi këtë analizë u propozua ky dokument strategjik dhe plan veprimi i përditësuar dhe në qershor 2019 u ndërmorën takime ku u dakordësuan gjetjet dhe propozimet, me profesionistë, ekspertë dhe aktorë të fushës së NE, PAK dhe Shërbimeve përfshirë shoqatat dhe drejtoritë e shërbimeve sociale bashkive, të cilat shërbyen për të përditësuar dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të mbrojtjes sociale në linjë edhe me përparësitë sektoriale të pushtetit vendor, në kuadër të reformës së decentralizimit.

Nëpërmjet këtij njoftimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ju fton të jepni kontributin Tuaj mbi dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të mbrojtjes sociale të rishikuar, përmes një procesi konsultimi publik online, sipas legjislacionit përkatës për konsultimin publik.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj

Dokumenta:

- [Formati PV_Dok Strategjik 2019](#)
- [Draft dokumenti strategjia e mbrojtjes sociale 2019](#)

Diskutimet
